

Florida Canolli, PhD Candidate¹

UDC: 342.72/.73.037:342.4(497.115)

**KONSTITUCIONALIZMI NË FUSHËN E MBROJTJES SË LIRIVE DHE
TË DREJTAVE TË NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**КОНСТИТУЦИОНАЛИЗМОТ ВО ОБЛАСТА НА ЗАШТИТАТА НА
СЛОБОДИТЕ И ЧОВЕКОВИТЕ ПРАВА ВО РЕПУБЛИКА КОСОВО**

**CONSTITUTIONALISM IN THE FIELD OF PROTECTION OF HUMAN
RIGHTS AND FREEDOMS IN THE REPUBLIC OF KOSOVO**

Abstract

On the verge of further accession to international organizations, the Republic of Kosovo, which symbolizes a new country with a developing democracy, needs to make significant legal and institutional changes and provide solutions to complex issues arising from previous structures in order to increase efficiency in protecting human rights and freedoms, based on the best practices of democratic countries, as well as the respect for international conventions, directives, and regulations that guarantee human rights and freedoms in general. Therefore, in this study, I will address the topic of human rights and freedoms in the Republic of Kosovo from a legal perspective, as well as some current problems faced during their implementation in practice. The protection of human rights is a very important and necessary challenge to ensure a free, equal, and democratic social environment for all. Considering the “Universal Declaration of Human Rights,” it is essential that human rights in the Republic of Kosovo are protected based on the proper development of the legal system, where the rule of law and democratic order prevail. The Constitution of the Republic of Kosovo contains important provisions for the protection and promotion of human rights. These provisions are fundamental to guarantee the basic rights and freedoms of the citizens of Kosovo. It is crucial that institutions and citizens respect and implement them in practice.

¹ Autori është studente në studimet e Ciklit të tretë në Fakultetin Juridik në Universitetin e Evropës Juglindore-Tetovë, Drejtimi: E drejta Kushtetuese dhe Administrative. E-mail: fc32369@seeu.edu.mk

In the Republic of Kosovo, there is a strong commitment to the protection and promotion of human freedoms and rights. A number of documents and strategies have been developed to ensure that the fundamental human rights are respected and protected in every aspect of society. These documents and strategies issued by the country's institutions are essential to building a society with equal rights for all citizens of the Republic of Kosovo.

Hyrje

Konstitucionalizmi në Fushën e Mbrojtjes së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut është një koncept i rëndësishëm që lidhet ngushtë me organizimin dhe funksionimin e një shteti demokratik. Të drejtat e njeriut, janë të drejta natyrore që natyra ua ka dhënë të gjithë njerëzve të cilat janë të pandashme dhe të patjetërsueshme prej tyre. Të drejtat e njeriut janë jetike, të domosdoshme për një shoqëri moderne të lirë dhe demokratike, e cila pa to nuk do të mund të funksiononte dhe nuk do të zhvillohej si një shoqëri e lirë. Të drejtat e njeriut në Kosovë kanë qenë një temë e rëndësishme dhe e ndjeshme gjatë viteve të fundit. Në këtë periudhë, janë ndërmarrë disa hapa për te garantuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut. Në kontekstin e Kosovës, konstitucionalizmi përfshinë disa aspekte të rëndësishme juridike, e të cilat janë trajtuar me hollësi në disa aspekte të rëndësishme të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës. Njohja e dinjitetit dhe të drejtave të barabarta, të patjetërsueshme të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë, barazisë dhe paqes në botë. Mos respektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut qon drejtë veprimeve barbare, që fyen lirinë e fjalës, lirinë e besimit dhe lirinë nga frika dhe skamja që është shpallur si aspirata më e lartë e çdo njeriu. Të gjithë popujt kanë të drejtën e vetëvendosjes, ata përcaktojnë lirisht statusin e tyre politik dhe sigurojnë në liri zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor. Gjatë këtij punimi do të analizoj se sa respektohen të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, të drejta këto që i gëzon çdo qytetar i botës në mënyrë universale. Aktet kryesore juridike në Republikën e Kosovës që i mbështesin këto liri dhe të drejta të njeriut janë:

- **Kushtetuta e Kosovës:** Kushtetuta e Republikës së Kosovës është ndër kushtetutat me miqësore në botë ndaj të drejtës ndërkombëtare në përgjithësi dhe veçanërisht ndaj të drejtës ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut. Kushtetuta e Kosovës në mënyrë të tërthortë ka pranuar epërsinë e së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtën e brendshme. Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë e njeriut si e drejta për jetë të barabarte, liri, siguri, liri fetare, të shprehjes dhe shumë të drejta tjera.

- **Legjislacioni përkatës në fushën e mbrojtjes së drejtave të njeriut (ligjet dhe aktet nënligjore):** Gjithashtu edhe aktet tjera juridike që garantojnë liritë dhe drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës.

- **Gjykata Kushtetuese e Kosovës:** Ky institucion është përgjegjës për ta vlerësuar konformitetin-kushtetutshmërinë e ligjeve dhe akteve tjera juridike me Kushtetutën. Ajo gjithashtu vendos ne rastet e konkretizuara për liritë dhe të drejtat e njeriut nëse shkelen ato.

- **Strategjitë nacionale:** Dokumente shumë me rëndësi në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut.

- **Konventat ndërkombëtare:** Përfshijnë konventat dhe instrumentet ndërkombëtare të obliguara bazuar në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

- **Organizatat e ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut:** Shoqëria civile dhe organizatat e të drejtave të njeriut luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ato ndjekin zhvillimet, raportojnë për shkeljet eventuale të drejtave të njeriut, dhe ndihmojnë qytetarët në kërkimin e drejtësisë.

- **Raportet vjetore për të drejtat e njeriut:** Institucionet e Republikës së Kosovës, Organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet ndërkombëtare përgatisin raporte vjetore që analizojnë situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Këto raporte ofrojnë një vështrim të hollësishëm mbi sfidat dhe përmirësimet në këtë fushë.

Qëllimi dhe objektivat

- **Analiza e ligjeve dhe politikave:** Kjo përfshinë studimin e konventave ndërkombëtare, ligjeve vendore dhe praktikave me të mira të krijuara nga institucionet e vendit.

- **Identifikimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut:** Bëhet përmes studimit të rasteve individuale, raporteve të organizatave joqeveritare, dhe monitorimit të situatës në teren.

- **Ndërgjegjësimi dhe edukimi:** Edukimi në shkolla dhe në komunitete është thelbësor për të promovuar respektimin e të drejtave të njeriut.

- **Rekomandimet dhe politikat:** Rekomandimet dhe politikat mund të adresojnë sfidat aktuale dhe të propozoj veprime konkrete në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

- **Ndikimi në zbatimin e lirive dhe të drejtave të njeriut:** Kjo përfshinë ndikimin në institucione, shoqëri civile dhe opinionin publik. Hulumtimi në fushën e të drejtave të njeriut ka për qëllim të kontribuoj në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë.

Hipotezat:

- **Respektimi i të drejtave të njeriut në Kosovë:** Kjo hipoteze sugjeron se zbatimi i ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në

Kosovë do të ndihmonte në një rritje të respektimit të këtyre të drejtave. P.sh, nëse institucionet e shtetit dhe shoqëria civile punojnë së bashku për të ndërgjegjësuar publikun dhe për të ndëshkuar shkelësit e të drejtave të njeriut, do të kemi një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë.

• **Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut:** Kjo hipotezë sugjeron se edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre themelore do të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit për respektimin e këtyre të drejtave. P.sh, kur njerëzit njohin të drejtat e tyre, ata janë me të aftë të kërkojnë drejtësi dhe të mbrojnë veten ndaj shkeljeve.

• **Rritja e përfshirjes së shoqërisë civile:** Kjo hipotezë sugjeron se përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin dhe ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut do të ndihmojë në forcimin e këtyre të drejtave. P.sh, kur OJQ-të dhe aktivistet e të drejtave të njeriut punojnë së bashku me institucionet shtetërore, ata mund të ndikojnë në ndryshime pozitive në politikat dhe praktikën e zbatimit të tyre.

Metodologjia e hulumtimit

Disa nga elementet e metodologjisë së hulumtimit në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut:

• **Analiza e gjendjes dhe identifikimi i problemeve:**

- Grumbullimi i të dhënave për të kuptuar situatën aktuale
- Vlerësimi i bazuar në të drejtat e njeriut për të identifikuar problemet dhe sfidat.

• **Planifikimi i politikave, strategjive dhe programeve:**

- Përcaktimi i qëllimeve dhe prioritetëve bazuar në të drejtat e njeriut.
- Menaxhimi i bazuar në rezultate për të siguruar zbatimin e politikave dhe programeve.

• **Implementimi:**

- Zbatimi i politikave dhe masave për të drejtat e njeriut.
- Sigurimi që të gjithë aktorët e përfshirë të respektojnë të drejtat themelore.

• **Monitorimi:**

- Vlerësimi i efektivitetit dhe ndikimit të politikave dhe masave.
- Përdorimi i indikatorëve për të vlerësuar realizimin e të drejtave të njeriut.

Rëndësia e hulumtimit:

Rëndësia e hulumtimit për të drejtat e njeriut: Është proces i rëndësishëm që ndihmon në kuptimin, dokumentimin dhe promovimin e të

drejtave themelore të njeriut. Këtu janë disa arsye pse hulumtimi në këtë fushë është shumë i rëndësishëm:

• ***Ndikimi në politika dhe në nxjerrjen e ligjeve:***

- Hulumtimi ndihmon në identifikimin e sfidave dhe rastet e mundshme të shkeljeve të drejtave të njeriut. Rezultatet e hulumtimit mund të ndikojnë në krijimin e politikave shtetërore, nxjerrjen e ligjeve si dhe në garantimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

• ***Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut:***

- Ky punim dhe hulumtim do të ndihmoj në ndërgjegjësimin e publikut për të drejtat e njeriut.

- Përmes informacionit të mbledhur, mund të edukohemi dhe të ndihmojmë të tjerët të kuptojnë rëndësinë e këtyre të drejtave.

• ***Monitorimi i zbatimit i të drejtëve të njeriut:***

- Hulumtimi ndihmon në vlerësimin e zbatimit të të drejtave të njeriut në praktikë.

- Përmes monitorimit, mund të identifikohen problemet dhe të ndërmerren masa korrigjuese.

• ***Ndikimi në organizatat ndërkombëtare dhe tek donatorët:***

- Rezultatet e hulumtimit që do t'i bëjë gjatë këtij punimi shkencor mund të ndihmojnë në qasjen pozitive, pse jo edhe në gjetjen e mundësive për investime të organizatave ndërkombëtare dhe donatorët e ndryshëm.

- Përmes punimit dhe hulumtimit, mund të paraqiten nevojat dhe sfidat e ndryshme për fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në përfundim, përmes këtij punimi synoj që të hulumtoj më në detaje për mbrojtjen e lirive dhe të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, i cili është një kusht i domosdoshëm për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të barabarte për të gjithë.

Konstitucionalizmi në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut

Të drejtat e njeriut kanë të bëjnë me të drejtat themelore të tyre të cilat mbrohen me Kushtetutë² dhe ligj³, e të cilat garantojnë lirinë e barazinë në mes njerëzve. Këtë e gjejmë në nenin e parë⁴ të Deklaratës Universale e të Drejtave të Njeriut, Citoj: Të gjithë njerëzit lindin të lirë e të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të drejta. Ata janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me frymë vëllazërore. Të drejtat e njeriut janë një pjesë e rëndësishme e teorive të së drejtës dhe një koncept i

² Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

³ Shih: Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës, 2015.

⁴ Shih: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948, neni 1.

rëndësishëm filozofiko-politik. Mes të drejtave themelore të qenies njerëzore janë e drejta e lirisë individuale, e drejta për jetën, e drejta e vetëvendosjes, e drejta e fesë etj. Të drejtat e njeriut përshkruajnë një koncept sipas të cilit të gjithë njerëzve iu takojnë që nga lindja të drejtat universale njerëzore. Të gjithë njerëzit sa lindim, kemi të drejta të caktuara, të quajtura të drejtat e njeriut. Këto të drejta i takojnë secilit dhe janë të patjetërsueshme, d.m.th., ato nuk mund t'i mohohen askujt. Të drejtat e njeriut janë të drejtat e individit për mbrojtje ndaj ndërhyrjeve të shtetit, që i janë dhënë atij për shkak të ekzistencës si qenie njerëzore, këto të drejta janë të përhershme dhe nuk mund të kufizohen nga shteti. Nga koha e luftës kundër absolutizmit rrjedh edhe karakterizimi i tyre si të drejta të lindura dhe patjetërsueshme. Thelbi i të drejtave themelore apo i të drejtave të njeriut, janë dinjiteti i njeriut, e drejta e shprehjes së personalitetit, trajtimit të barabartë dhe barazisë para ligjit, liria e besimit dhe ndërgjegjes, e mendimit të lirë, shtypit, informimit dhe e mësimi, liria e mbledhjes dhe e bashkimit, liria e profesionit dhe e punës, pacenueshmëria e banesës, garantimi i pasurisë dhe i të drejtës së trashëgimisë, e drejta e strehimit politik dhe e peticionit, si dhe të drejtat juridike, si garanci kundër arrestimit të padrejtë. Në zhargonin politik, përkufizimi të drejtat e njeriut paraqet në radhë të parë tërësinë e atyre të drejtave, të cilat individ mund t'i kërkojë vetëm për shkak të ekzistencës së tij si qenie njerëzore, dhe që duhet të sigurohen me ligj nga bashkësia për arsye etike. Në këtë kontekst bëhet fjalë edhe për të drejtat natyrore, para atyre shtetërore të lindura apo të patjetërsueshme, në respektimin dhe sigurimin e të cilave legjitimohet një bashkësi politike.

Konstitucionalizmi në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës

Konstitucionalizmi është koncepti obligues apo detyrues në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Në Republikën e Kosovës, ky koncept është detyrues si dhe është i përcaktuar në Kushtetutën⁵ dhe legjislacionin tonë. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pa cenueshme dhe janë bazë e të cilat qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik të Republikës së Kosovës. Organet e pushtetit publik në Republikën e Kosovës, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Kushtetuta e Kosovës përmban shumë dispozita në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut. Neni 3 i Kushtetutës deklaron se autoritetet publike në Kosovë sigurojnë barazinë e të gjithë individëve para ligjit dhe respektimin e plote të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, Neni 7 përcakton që rendi kushtetues i Kosovës bazohet, mes tjerash, në parimet e barazisë, respektimit

⁵ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3 dhe neni 7.

të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe mos diskriminimit, si dhe mishëron barazinë gjinore⁶ si vlerë themelore. Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me Kushtetutën⁷ e Republikës së Kosovës, dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike në Republikën e Kosovës: Marrëveshjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare si në vijim:

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj
3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet
4. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
5. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
6. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
7. Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
8. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerezore dhe Poshtëruese.
9. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje.

Republika e Kosovës ka nxjerr një mori ligjesh⁸ dhe akte tjera juridike me qëllim të mbrojtjes dhe garantimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare⁹ a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, e njerëzor ose poshtëruar. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose në pozitë të ngjashme me skllavërinë. Askush nuk mund të shtrëngohet për të kryer punë¹⁰ të detyruar.

⁶ Shih: Ligjin për Barazi Gjinore në Republikën e Kosovës.

⁷ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

⁸ Shih: Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës, Ligji për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve në Republikën e Kosovës, Ligji për Lirinë Fetare në Republikën e Kosovës.

⁹ Shih: Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

¹⁰ Shih: Ligji i Punës në Republikën e Kosovës.

Punë e detyruar nuk konsiderohet puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për personat e dënuar me vendim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit ose në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme, të shpallur sipas rregullave të përcaktuara me këtë Kushtetutë. Andaj duhet t'i kushtohet kujdes i shtuar mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të mos lejohet diskriminim në një shoqëri demokratike siç është Republika e Kosovës.

Mosdiskriminimi

Mosdiskriminimi¹¹ është një parim i rëndësishëm i të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë që askush nuk duhet të trajtohet ndryshe ose të përjashtohet nga të drejtat e tij ose të drejtat e saj bazuar në racë, ngjyrë, gjini, besimit fetarë, orientim seksual, ose ndonjë tjetër karakteristikë personale. Në një shoqëri të drejtë dhe të barabartë, të gjithë individët duhet të kenë mundësi të barabarta për të gëzuar të drejtat e tyre themelore. Diskriminimi është një shkelje e këtij parimi dhe duhet të luftohet në mënyrë aktive. Secilit individ i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës¹² kompetente, si në vijim: pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale, për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj, për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm, për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë, për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë¹³ e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera. Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë fetare¹⁴ dhe monumentet fetare¹⁵ brenda territorit të saj. Konfesionet fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm, veprimtaritë fetare, si dhe ritet fetare. Liria e shprehjes është e garantuar e cila përfshinë të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë

¹¹ Shih: Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës,

¹² Shih: Kodin e Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 12

¹³ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 3, Kodi i Procedurës Penale, neni 9.

¹⁴ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 8 dhe neni 39.

¹⁵ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 9.

është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetërorë, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë. Familja gëzojnë mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj. Liria e asociimit¹⁶ ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit mes kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë¹⁷ dhe të drejtën për tu zgjedhur¹⁸, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve. E drejta e pronës¹⁹ është e garantuar me Kushtetutë dhe legjislacionin e vendit. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. Republika e Kosovës do të promovojë ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjese përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës siguron, në baza jo diskriminuese, që të gjitha komunitetet²⁰ dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me këtë Kushtetute. Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet: të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhen, traditat dhe kulturën e tyre. Komunitetet²¹ dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu veçanërisht në shërbimin policor në

¹⁶ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 44 parag. 1, 2 dhe 3.

¹⁷ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 45 parag. 1.

¹⁸ Shih: Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën së Kosovës neni 6 parag. 1.

¹⁹ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 46 parag. 1, 2 dhe 3.

²⁰ Shih: Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

²¹ Shih: Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike. Mirëpo pavarësisht kësaj edhe Kosova ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm shoqërorë dhe politik në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, në mënyrë që të parandalohen çfarëdo forme e mundshme e diskriminimit. Po paraqesim disa forma²² të diskriminimit me të cilat shoqëria e jonë mund të jetë më e rrezikuar:

Disa forma të mundshme të diskriminimit

Diskriminimi është një realitet me të cilin shumë njerëz ballafaqohen në fusha të ndryshme të jetës se tyre çdo ditë. Kjo ndodh kur individët trajtohen në mënyrë të parapëlqyer, të padrejtë ose të pabarabartë bazuar në karakteristikat personale si raca, feja, aftësia, mosha, kombësia, ose gjinia (identiteti gjinor, orientimi seksual, shtatzënia). Këtu janë disa forma të diskriminimit:

- **Diskriminimi sipas moshës**²³: Përfshin trajtim të padrejtë bazuar në moshë. Kjo mund të ndodhë në punë, rekrutim, promovim, ose trajtim të barabartë në trajnim.

- **Diskriminimi sipas aftësisë**²⁴ (**diskriminimi kundër personave me aftësi**): Kur individët trajtohen në mënyrë të padrejtë për shkak të aftësive të tyre fizike ose mendore. Kjo mund të përfshijë mungesën e qasjes në vendet e punës, shkollë, ose ndërtesa të tjera.

- **Diskriminimi indirekt**: Ndodh kur politikat, praktikat ose rregullat e një organizate kanë pasoja të padrejta për një grup të caktuar të njerëzve. Për shembull, në test që diskriminon një grup të veçantë të njerëzve.

- **Diskriminimi fetar**²⁵: Kur individët trajtohen ndryshe për shkak të besimit të tyre fetar. Kjo mund të përfshijë refuzimin e punës, shërbimeve, ose qasjes në vendet e kultit.

- **Diskriminimi seksual**²⁶: Përfshin trajtim të padrejtë bazuar në gjininë ose orientimin seksual. Kjo mund të ndodhë në vendet e punës, shoqëri, ose në familje.

- **Diskriminimi racor**: Kur individët trajtohen ndryshe për shkak të prejardhjes së tyre racore. Kjo mund të përfshijë refuzimin e qirasë, blerjen e pronës, ose trajtim të padrejtë në sistemin e drejtësisë penale.

²² Shih: Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës.

²³ Shih: Raporti nga Shoqëria Civile mbi të Drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës

²⁴ Shih: Raporti nga Zyra për Qeverisje të Mirë mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës.

²⁵ Shih: Raporti nga Shoqëria Civile mbi të Drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës.

²⁶ Shih: Raporti vjetor i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës,

• **Diskriminimi në bazë të statusit si prind:** Kur individët trajtohen ndryshe për shkak të statusit si prind. Kjo mund të ndodhë në vendet e punës, në qira, ose në blerjen e pronës.

Si mund ta ndalojmë diskriminimin në shoqëri

Në mënyrë që të ndalojmë diskriminimin në shoqëri, institucionet e vendit duhet të marrin hapa të guximshëm dhe të krijojnë një mjedis të barabartë dhe të drejtë për të gjithë. Këtu janë disa masa që mund të ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm në mbrojtjen të drejtave të njeriut nga diskriminimi në çfarëdo rrethanë qofshin ato:

• **Ndërgjegjësimi dhe Edukimi:**

- Është e rëndësishme që të gjithë qytetarët të jenë të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre dhe për ndalimin e diskriminimit. Edukimi²⁷ dhe ndërgjegjësimi në shoqëri janë hapat e parë drejt ndryshimit.

- Edukimi për të drejtat e njeriut nënkupton shkollimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informimin, praktikat dhe veprimtaritë që ato synojnë përmes pajisjes së nxënësve pse jo edhe qytetarëve me njohuri, aftësi, qëndrime dhe sjellje që i aftësojnë dhe i fuqizojnë ata për të ushtruar dhe për të mbrojtur të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri. Roli i institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e ligjit dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve. Ata duhet të bashkëpunojnë për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e diskriminimit.

- Ligji²⁸ kundër diskriminimit në Kosovë është një instrument ligjor që synon të parandalojë dhe luftojë diskriminimin në bazë të kombësisë, origjinës sociale, racës, etnisë, gjinisë, orientimit seksual, gjuhës, besimit fetar, dhe shumë të tjera karakteristika. Vazhdimi i përpjekjeve për të ndërgjegjësuar dhe edukuar qytetarët, zbatimin e ligjit, dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve është thelbësor për të arritur një shoqëri ku diskriminimi nuk ka vend.

- Të përkrahen iniciativa që promovojnë barazinë dhe diversitetin. Kjo mund të jetë përmes aktiviteteve në komunitete, fushatave të ndryshme të ndërgjegjësimit, ose pjesëmarrjes në organizata²⁹ të ndryshme që promovojnë drejtat e njeriut.

- Kosova në kushtetutën³⁰ e saj i ka pjesë përbërës instrumentet dhe konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

• **Si ta sfidojmë diskriminimin dhe racizmin e përditshëm:**

Këtu janë disa hapa që mund të ndihmojnë që të sfidojmë diskriminimin:

²⁷ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 29.

²⁸ Shih: Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës.

²⁹ Shih: Ligji për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

³⁰ Shih: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 22.

- Edukimi mbi çështjet e diskriminimit dhe të drejtat e njeriut. Duhet të informohet shoqëria përmes: programeve të ndryshme që pasqyrojnë mosdiskriminimin, leximit të literaturave vendore dhe botërore, akteve juridike që sanksionojnë diskriminimin. Organizimi i sesioneve të ndërgjegjësimit në komunitetin ku jetoni dhe veproni për të diskutuar rreth diskriminimit dhe barazisë³¹.

- Të ndihmojmë fëmijët³² dhe të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e respektit dhe barazisë. Edukimi fillon qysh në moshën e hershme kundër dukurive negative dhe diskriminuese në shoqëri.

- Të tregojmë respekt dhe mirëkuptim ndaj të gjithë individëve, pa dallim të karakteristikave të tyre personale.

- Të mos lejojmë që paragjykimet ose stereotipat të ndikojnë në sjelljen e individëve në komunitetin ku jetojnë me anëtarët e familjes, miqtë ose kolegët në përgjithësi.

- Të mundohemi që të inkurajojmë që të rinjtë të mësojnë më shumë rreth kontekstit historik të paragjykimeve racore³³ dhe diskriminimit, t'i ndajmë burimet që kemi gjetur për ta vetëdukuar atë komunitet dhe shoqërinë në përgjithësi.

Si mund t'i mbrojë individi të drejtat e veta

Mbrojtja e të drejtave të individit është një proces i rëndësishëm dhe ka disa hapa që mund të ndiqni nëse ndiheni se liritë dhe drejtat tuaja janë shkelur:

• **Informimi mbi të drejtat tuaja:** Njohja e të drejtave të tua është hapi i parë. Lexoni dokumente³⁴ si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe ligjet³⁵ vendore që i mbrojnë ato.

• **Kërkimi i ndihmës juridike:** Nëse mendoni se të drejtat tuaja janë shkelur, konsultohuni me një avokat³⁶ ose organizate të drejtave të njeriut për ndihmë dhe këshilla juridike.

• **Paraqitja e ankesës:** Nëse keni prova për shkeljen e të drejtave tuaja, paraqitni një ankesë tek organet kompetente, si gjykatat, prokuroria, ose institucionet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

• **Përdorni mekanizmat ndërkombëtarë:** Nëse shkelja e të drejtave tuaja ka ndodhur në nivel ndërkombëtar, mund të paraqisni ankesë tek Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ose tek Komiteti i të Drejtave të Njeriut të

³¹ Shih: Strategjia për Avancimin e të drejtave të komuniteteve në Republikën e Kosovës.

³² Shih: Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve në Republikën e Kosovës.

³³ Shih: Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial.

³⁴ Shih: Deklaratën Universale e të drejtave të njeriut .

³⁵ Shih: Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës.

³⁶ Shih: Ligji për Avokatin e Popullit në Republikën e Kosovës.

Kombeve të Bashkuara (tani për tani qytetarët e Kosovës e kanë të pamundur të bëjnë një gjë të tillë për arsye se Kosova akoma s'është njohur nga këto dy institucione).

• **Ndërmarrja e veprime të qëndrueshme:** Përveç ndjekjes së procedurave ligjore, ndërmerrni veprime të qëndrueshme për të parandaluar shkeljen e të drejtave tuaja në të ardhmen.

Si mund ta ndalojmë diskriminimin në vendet e punës

Kushtetuta e Kosovës garanton mbrojtjen e barabartë ligjore dhe mosdiskriminimin, të drejtën për punë³⁷ dhe lirinë për të zgjedhur profesionin dhe lirinë e asocimit, përfshirë lirinë për të themeluar sindikata. Në mënyrë që të ndalojmë diskriminimin në vendet e punës, duhet të ndërmerren hapa konkret me qëllim që të krijojmë një mjedis të barabartë dhe të drejtë për të gjithë punonjësit. Këtu janë disa masa që mund të ndihmojnë:

• **Politikat dhe procedurat e qarta:** Institucionet shtetërore, kompanitë dhe organizatat duhet të kenë politika dhe procedura të qarta kundër diskriminimit. Këto duhet të përfshijnë rregulla për trajtimin e barabartë³⁸ të të gjithë punonjësve, përfshirë rastet e diskriminimit.

• **Trajnimi i punonjësve:** Trajnimi i punonjësve rreth çështjeve të mosdiskriminimit³⁹ është thelbësor. Ata duhet të jenë të informuar për liritë dhe të drejtat e tyre dhe përparësitë e një mjedisi të barabartë.

• **Monitorimi i barazisë:** Institucionet duhet të monitorojnë barazinë⁴⁰ dhe të ndjekin shpalljen e rasteve të diskriminimit. Kjo mund të bëhet përmes anketeve, raporteve të incidenteve, dhe vlerësimit të përgjithshëm të klimës së punës.

• **Përfshirja e diversitetit:** Përfshirja e njerëzve nga grupe të ndryshme (p.sh., raca, gjinia, orientimi fetar etj.), në të gjitha nivelet e institucioneve të vendit ndihmon në parandalimin e diskriminimit. Krijimi i një mjedisi të hapur dhe të respektuar për të gjithë është thelbësor.

• **Zhvillimi i një kulture të ndërgjegjshme:** Nëpërmjet trajnimeve dhe komunikimit të vazhdueshëm, institucionet vendore duhet të promovojnë ndërgjegjësimin rreth diskriminimit dhe të ndihmojnë në ndërtimin e një kulture të përgjegjshme dhe ndërgjegjshme.

• **Përgjegjësia dhe ndëshkimi:** Rastet e diskriminimit duhet të hetohen⁴¹ dhe të trajtohen seriozisht. Institucionet që shkelin politikat e barazisë duhet të ndëshkohen në përputhje me ligjet dhe aktet tjera të zbatueshme.

³⁷ Shih: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 49.

³⁸ Shih: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 49.

³⁹ Shih: Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës.

⁴⁰ Shih: Ligji për Barazi Gjinore Republikën e Kosovës

⁴¹ Shih: Ligji për Avokatin e Popullit në Republikën e Kosovës. Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës, Kodi i Procedurës Penale.

• **Respektimi i ligjeve që mbulojnë të drejtat e punëtorëve në punë:** Në Kosovë kemi disa ligje të cilat i përcaktojnë të drejtat e punëtorëve⁴² si: Ligji i Punës, Ligji për Inspektoratin e Punës, Ligji për Sigurimin e Shëndetit në Punë, Ligji për Organizimin Sindikal, Ligji për Zyrtarët Publik, Ligji i Pagave në Sektorin Publik etj.

Respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës

Kosova ka pasur shumë progres në krijimin e bazës së mirëfilltë ligjore për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarëve të saj që jetojnë në Kosovë. Edhe raportet⁴³ vendore dhe ato ndërkombëtare⁴⁴ e vërtetojnë një gjë të tillë, edhe pse gjithmonë ka nevojë për të bërë më shumë në zbatimin në praktikë të këtyre të drejtave të njeriut. Në Kosovë, mbrojtja e të drejtave të njeriut përballë sfidave të ndryshme është një çështje e rëndësishme, andaj rregullisht bëhen hulumtime dhe analiza nga institucionet dhe shoqëria civile.

Qëllimi i hulumtimit në fushën e të drejtave të njeriut është i gjerë dhe përfshin disa aspekte:

• **Analiza e ligjeve dhe politikave:** Hulumtimi synon të analizojë legjislacionin dhe politikat që lidhen me të drejtat e njeriut. Kjo përfshin studimin e konventave ndërkombëtare, ligjeve vendore dhe praktikave të institucioneve të vendit.

• **Identifikimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut:** Hulumtimi ndihmon në identifikimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në praktikë. Kjo mund të jetë përmes studimit të rasteve individuale, raporteve të organizatave ndërkombëtare⁴⁵ dhe atyre joqeveritare, dhe monitorimit të situatës në terren.

• **Ndërgjegjësimi dhe edukimi:** Hulumtimi ndihmon në ndërgjegjësimin e publikut dhe ndërgjegjësohet për të drejtat e tyre. Edukimi në shkollat dhe në komunitetet është thelbësor për të promovuar respektimin e të drejtave të njeriut.

• **Rekomandimet dhe politikat:** Hulumtimi⁴⁶ ndihmon në formulimin e rekomandimeve dhe politikave për të forcuar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Këto rekomandime mund të adresojnë sfidat aktuale dhe të propozojnë veprime konkrete me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

⁴² Shih: Ligji i Punës në Republikën e Kosovës neni 5.

⁴³ Shih: Raporti i Shoqërisë Civile mbi të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës 2020-2021.

⁴⁴ Shih: Raporti i organizatave ndërkombëtare (OSBE).

⁴⁵ Shih: Raporti nga: Human Rights Watch (HRW) për vitin (janar 2023).

⁴⁶ Shih: Raporti i Shoqërisë Civile mbi të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës 2020-2021.

• **Monitorimi i zbatimit të të drejtave të njeriut:** Përmes monitorimit⁴⁷, mund të identifikohen problemet dhe të ndërmerren masa korrigjuese, si në përmirësimin e legjislacionit ashtu edhe në zbatimin e tyre në praktikë.

• **Ndikimi në zbatimin e të drejtave të njeriut:** Hulumtimi mund të ndihmojë në ndikimin e politikave dhe praktikave që sigurojnë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo përfshin ndikimin në institucione⁴⁸, shoqëri civile dhe opinionin publik.

Republika e Kosovës ka nxjerr një mori ligjesh, akte nënligjore, strategji të ndryshme në mbështetje dhe garantimin e lirive dhe drejtave të njeriut, por po i përmendi vetëm disa: Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Lirinë e Fjalës dhe të Informacionit, Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut, Ligji për Barazinë Gjinore dhe Përbërjen e Këshillit për Barazi Gjinore, Strategji⁴⁹ të ndryshme për promovimin e drejtave të njeriut. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut Qeveria e Kosovës i ka të themeluara: Agjencinë për Barazi Gjinore e cila ka mandat të hartojë, të zbatojë, të propozojë, të koordinojë të monitorojë politika publike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore, Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM), Zyrën për Komunitete, Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, këto institucione funksionojnë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Megjithatë në fushën e të drejtave të njeriut gjithmonë ka nevojë për një përkujdesje të vazhdueshme dhe avancim të mëtejme në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kosova si shtet i ri, me aspirata të mëdha për integritet evropian duhet të bëjë më shumë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Po i potencojmë disa shkelje të lirive dhe drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës sipas raporteve vendore dhe ndërkombëtare:

Shkelja e të drejtave të njeriut në Kosovë është në çështje e rëndësishme dhe komplekse. Raportet e organizatave⁵⁰ të të drejtave të njeriut ofrojnë një vështrim të hollësishëm mbi këtë temë. Le të shqyrtojmë disa aspekte të shkeljeve të të drejtave të njeriut në Kosovë:

• **Të drejtat civile dhe politike:**

- Trajtimi njerëzor dhe ndalimi i torturës: Ka pasur raste të raportuara për trajtim të keq, torturë dhe dhunë fizike ndaj personave në kujdesin e autoriteteve⁵¹ kompetente.

⁴⁷ Shih: Raporti vjetor i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës,

⁴⁸ Shih: Ligjin për Barazinë Gjinore, ligjin kundër diskriminimit, ligjin e Avokatit të Popullit, etj.

⁴⁹ Shih: Strategjia Kombëtare për mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe dhuna ndaj Grave 2022-2026

⁵⁰ Shih: Raporti i shoqërisë civile mbi të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, 2020-2021.

⁵¹ Shih: Raporti vjetor i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës, Raporti nga Zyra për Qeverisje të Mirë mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës.

- Liria e shprehjes dhe e mendimit⁵²: Në disa raste, gazetarët dhe aktivistët janë përballur me kufizime dhe kërcënime për shprehjen e mendimit të lirë të tyre. pavarësisht se Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton lirinë e mediave. Megjithatë, ka raportime që përfaqësuesit e mediave janë kërcënuar nga zyrtaret publikë, politikanët dhe bizneset.

- Liria e tubimit paqësor: Demonstratat dhe tubimet paqësore në të kaluarën kanë pësuar ndërprerje dhe ndalime nga autoritetet kompetente.

• ***Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore:***

- Të drejtat në punë: Puna⁵³ e papaguar nga punëdhënësit është evidente si dhe kushtet e këqija të punës, orar i gjatë i punës në sektorin privat shpesh herë edhe pa pagesën e kontributeve pensionale, janë sfida për shumë qytetar. Punëtorëve u shkelet e drejta e tyre, kjo sepse punëdhënësit shpesh nuk i respektojnë standardet zyrtare të punës për shkak të mungesës së detyrimit nga ana e Qeverisë. Punëtorët shpesh nuk i raportojnë shkeljet e tilla për shkak të frikës dhe masave që punëdhënësit mund t'i ndërmarrin ndaj tyre.

- E drejta për arsim⁵⁴: Qasja në arsim fillor dhe në nivelet tjera të arsimit ende është një sfidë shumë e madhe për disa komunitete që jetojnë në Kosovë.

- E drejta për kujdes shëndetësor⁵⁵: Në disa raste, qytetarët kanë hasur vështirësi të shumta në qasjen dhe mbikëqyrjen e kujdesit shëndetësor.

- Me shkelje të drejtave përballen edhe personat me aftësi të kufizuara. Edhe pse Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e tyre. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase ligjet dhe programet për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në institucione, informata dhe komunikim.

• ***Të drejtat e personave ose grupeve të caktuara:***

- Të drejtat e grave⁵⁶ dhe barazia gjinore: Diskriminimet në aspektin gjinor ende janë sfida të mëdha për vendin, edhe pse ka përmirësime në këtë drejtim (punësim, garantim i përfaqësimit në parlament, qeveri etj.).

- Të drejtat e komuniteteve⁵⁷: Komunitetet e ndryshme, përfshirë komunitetin LGBTI+, janë përballur me diskriminim dhe kufizime.

⁵² Shih: Raporti i shoqërisë civile mbi të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, 2022/23.

⁵³ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 49, Ligji i Punës në Republikën e Kosovës.

⁵⁴ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 47, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 3, paragrafi 1.

⁵⁵ Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 51, Ligji për Shëndetësin, neni 5.

⁵⁶ Shih: Ligji për Barazi Gjinore Republikën e Kosovës, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje.

⁵⁷ Shih: Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Raporti nga ZQM mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, 2022.

• **Çështje të ndërlidhura/çështje specifike e të drejtave të njeriut:**

- Kushtetuta⁵⁸ dhe instrumentet ndërkombëtare⁵⁹ në fuqi i mbrojnë të drejtat e qytetarëve për proces gjyqësor të drejtë dhe mjete juridike efektive.

- Gjykatat⁶⁰ duhet të punojnë për ta rritur efikasitetin e gjykatësve në trajtimin e rasteve dhe uljen e numrit të rasteve të pazgjidhura i cili mbetet i lartë, gjithashtu gjykatat duhet të punojnë në respektimin e afateve procedurale në shqyrtimin e lëndëve.

- Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut: Procesi i ndjekjes së kriminelëve për shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë luftës në Kosovë është një sfidë.

- Korrupsioni⁶¹ dhe të drejtat e njeriut: Korrupsioni akoma është prezent dhe si i tillë ka ndikim negativ në të drejtat e njeriut.

- Mjedisi dhe të drejtat e njeriut: Mjedisi-ambienti shumë i ndotur, si dhe shkatërrimi i burimeve natyrore kanë ndikim në të drejtat e njeriut.

Organizata joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë

Në Kosovë, ka disa organizata joqeveritare (OJQ) të përkushtuara për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Këtu janë disa prej tyre:

• **Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ):** Kjo organizatë, me seli në Prishtinë, është e para organizatë joqeveritare, jopolitike dhe jofitimprurëse e formuar në Kosovë (14 dhjetor 1989). Qëllimi i saj në fillim ishte që të dokumentoj rastet e abuzimit të të drejtave të njeriut gjatë regjimeve të asaj kohe. Kurse në kohën e sotme ky këshill luan rol shumë të rëndësishëm në informimin e opinionit publik përmes raporteve, komunikatave dhe publikimeve të ndryshme për mbrojtjen e të drejtave ligjore dhe të avokojë tek institucionet për mbrojtjen e të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore.

• **Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi (INJECT):** Kjo organizatë jofitimprurëse është e përqendruar në fuqizimin e grave për mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore. Ajo gjithashtu avokon për të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore të grave.

• **Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS):** ishte një organizatë që punon në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të drejtave të njeriut.

• **Handikosi:** E njohur si “Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës”, u themelua në vitin 1983. Misioni i Handikos-it është

⁵⁸ Shih: Kushtetutën e Republikës së Kosovës: Kapitulli II dhe III.

⁵⁹ Shih: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 22.

⁶⁰ Shih: Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Gjykatat.

⁶¹ Shih: Raporti nga ZQM mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, 2022.

të promovojë realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ajo punon në drejtim të integritetit të plotë të këtyre personave në shoqëri, lobimit për avancimin e të drejtave të tyre, ofrimit të shërbimeve cilësore në fushën e shëndetësisë, mirëqenies sociale, arsimit dhe punësimit, si dhe ofrimit të shërbimeve për rehabilitimin si dhe merret me mbështetjen e shërbimeve ligjore.

- **Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të Grave në Kosovë:** Është një organizatë joqeveritare (OJQ) që punon për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe interesat e grave në Kosovë. Kjo shoqatë ka një rol të rëndësishëm në luftën për barazi gjinore, ndalimin e dhunës ndaj grave dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së grave në vend.

- **Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF):** Është një koalicion i përbërë nga 34 organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i KOMF është të avokojë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. KOMF përfaqëson interesat e fëmijëve në institucionet qeveritare dhe ndërkombëtare. Ajo lobon për ndryshime ligjore dhe politika që do të përmirësojnë pozitën e fëmijëve në shoqëri.

E shumë organizata tjera joqeveritare, të cilat organizata luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe janë të përkushtuara për të ndihmuar qytetarët në këtë fushë.

Organizatat Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut që veprojnë në Republikën e Kosovës

Në Kosovë, ka disa organizata joqeveritare dhe organizata ndërkombëtare të përkushtuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këtu janë disa prej tyre:

- **Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) -** Misioni në Kosovë: Misioni i OSBE-së punon për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve, qeverisjen e mirë dhe standardet e sigurisë publike në Kosovë. Ky mision është i themeluar në vitin 1999 dhe është Misioni më i madh i OSBE-së..

- **Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH):** Kjo organizatë joqeveritare është e përkushtuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe Kosovë. Ajo monitoron zhvillimet në fushën e të drejtave të njeriut dhe ndërlidhet me organizata të tjera ndërkombëtare.

- **Civil Rights Defenders (CRD):** Kjo organizatë ndërkombëtare punon në Kosovë për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut. CRD monitoron situatën e të drejtave të njeriut dhe ofron mbështetje për organizatat vendore dhe aktivistët.

Këto organizata luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës dhe janë të përkushtuara për të ndihmuar qytetarët në këtë fushë.

Conclusions

The conclusions in the field of human rights in Kosovo are important for understanding the progress and challenges the country has faced in this regard. Here are some key conclusions:

- **Independence and the Constitution:**

- The declaration of independence of the Republic of Kosovo in 2008 marked a significant step toward the affirmation of human rights.

- The Constitution of the Republic of Kosovo defines the organizational structure of the state and guarantees the fundamental rights of citizens.

Constitutionalism in the field of the protection of human rights and freedoms in Kosovo is essential to ensure the respect and promotion of these rights. During the period 2021–2025, the Republic of Kosovo has established a strategic program to address human rights issues. This program aims to build a society where human rights are guaranteed and respected for all citizens. It represents an important step toward a more equal society for all people in Kosovo.

In this context, some of the conclusions and objectives of the human rights strategy in Kosovo include:

- **Protection of Fundamental Rights:** Ensuring the protection of fundamental human rights, including the right to life, liberty, and equality.

- **Improvement of the Legal System:** Enhancing the legal system to ensure that Kosovo's laws and policies meet international human rights standards.

- **Inclusion of Marginalized Groups:** Kosovo is a multiethnic society, and respecting the rights of ethnic communities is essential. Progress in this area remains an ongoing challenge. Kosovo has also made significant strides in recognizing and protecting the rights of LGBTI persons. However, challenges in this regard still persist.

- **Protection of Women's Rights and Gender Equality:** Advancing the guarantee of women's rights and gender equality is a priority. Strengthening laws and policies related to women's rights is essential.

- **Economic and Social Rights:** Progress in guaranteeing economic and social rights is crucial for citizens' well-being. Efforts to reduce poverty and improve social services have posed major challenges.

- **Promotion of Education and Awareness:** Raising awareness among citizens and institutions about human rights and promoting education in this field.

- **Monitoring and Reporting:** Improving monitoring and reporting mechanisms for human rights to ensure transparency and accountability.

In conclusion, the Government of Kosovo is continuously working to improve and strengthen the professionalism, accountability, transparency, efficiency, and effectiveness of the public administration at all levels of governance. This is essential for the effective implementation of laws, public

policies, as well as for the better protection and enforcement of human rights at the national level.

For the first time in Kosovo, the Human Rights Indicators Framework has been developed. This method also facilitates the distribution of responsibilities among different institutions, as it makes it easier to identify the indicators covered according to the legal responsibilities assigned to the respective institutions.

Policy development remains a priority for the government in the field of protection, respect, and enforcement of human rights. Therefore, in order to achieve a just and equal society, it is important that all actors—including the government, civil society, and individuals—work together to guarantee the freedoms and rights of all people in the Republic of Kosovo.

Recommendations

As recommendations in the field of the protection of human rights and freedoms in the Republic of Kosovo, I highlight the following:

- **Independence of oversight institutions:** Ensure the independence of oversight institutions, such as the Ombudsperson in Kosovo. These institutions should have the capacity and authority to investigate human rights violations and intervene effectively.
- **Development of professional capacities:** Invest in the training and development of human rights professionals, including lawyers, social workers, and police officers. Their capacities must be strong to ensure the protection of individuals' rights.
- **Public information and awareness:** Inform citizens about their rights and the procedures for filing complaints in cases of violations. Public awareness is essential for building a conscious and responsible society.
- **Protection of minority rights:** Strengthening laws and policies for the rights of minorities is essential. It must be ensured that minorities have equal access to public services and are protected from discrimination.
- **Freedom of Expression and Media:** Ensuring a free environment for media and journalists is crucial for human rights.
- **Monitoring the implementation of laws and judicial decisions:** Continuous monitoring of the implementation of laws and court decisions related to human rights should be ensured. In cases of violations, corrective measures must be taken.
- **International cooperation:** Kosovo should cooperate with international organizations and other partners to strengthen the protection of human rights. It should benefit from their experiences and support.
- **Reforms:** There is a need to amend, supplement, and harmonize the legal framework related to the protection of human rights and freedoms.

In conclusion, the Republic of Kosovo must continuously work to address these challenges and ensure the freedoms and human rights of all its citizens without distinction.

Recensentë:

Prof. dr. Blerton Sinani

Prof. dr. Islam Qerimi

Bibliografia:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike, 1996
- Pakti ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, (1966 ka hy në fuqi 1976)
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, (përfshirë amendamentet e mëvonshme)
- Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale në Republikën e Kosovës 2019/2022
- Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, 2008/ 2011 dhe 2012
- Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës, 2015
- Ligji për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve në Republikën e Kosovës, 2019
- Ligji për Barazi Gjimore Republikën e Kosovës, 2015
- Ligji për Lirinë Fetare në Republikën e Kosovës, 2007
- Ligji i Punës në Republikën e Kosovës, 2010
- Ligji për Shëndetësi në Republikën e Kosovës, 2013
- Ligji për Sigurinë e Shëndetit në Punë në Republikën e Kosovës, 2013
- Ligji për Organizimin Sindikal në Punë në Republikën e Kosovës, 2011
- Ligji për Inspektoratin e Punës në Republikën e Kosovës, 2002
- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011
- Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, 2023
- Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, 1966
- Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 2003
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, 1965
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas, 1979
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, 1989
- Konventa kundër torturës dhe trajtimeve e dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese, 1984

- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, 2011
- Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, 1950
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 1959
- Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve në Republikën e Kosovës 2022-2026 si dhe Plani i Veprimit
- Raporti nga Shoqëria Civile mbi të Drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, 2021
- Raporti nga ZQM mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, 2022
- Raporti i të Drejtave të Njeriut në Republikën e Maqedoninë së Veriut, 2021
- Raporti vjetor i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës, 2022
- Raporti nga Shoqëria Civile mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, 2022
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, 2022-2026,
- Rekomandimet e Këshillit të Evropës Kundër Racizmit dhe intolerancës, 2021
- Raporti i vlerësimit Ex-Post për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2024
- Direktiva e Këshillit të Evropës 2004/43/KE 29 qershor 2000 për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”*.
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *“Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*.
- Direktiva e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”*.
- Direktiva e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për *“ Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”*.

Ueb Faqet:

- Agjencia për Barazi Gjimore ne Kosovë: <https://abgj.rks-gov.net/>
- Zyra për Qeverisje të Mirë në Kosovë: <https://zqm.rks-gov.net/>
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/>
- Gazeta Zyrtare Evropiane: <https://eur-lex.europa.eu/>
- Forumi i Gazetave Zyrtare Evropiane: European Forum of Official Gazettes - European Forum of Official Gazettes - Publications Office of the EU (europa.eu)